



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 299/4 Prot.

Tiranë, më 27.04.2018

VENDIM

Nr.38, datë 27/04/2018

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES NË
AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT
PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 202, datë 04.10.2017 “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 252/5 prot., datë 04.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.252/6 prot., datë 04.10.2017 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”, i është njoftuar institucionit.

Institucioni i AAC, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 299, datë 28.02.2018, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Autoritetin e Aviacionit Civil, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 10 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr.600/1 prot., datë 16.03.2018, “Kthim përgjigje”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke paraqitur sqarime dhe u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Drejtori Ekzekutiv i Aviacionit Civil, duhet të konstatojë menjëherë si absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 302, datë 30.04.2014, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Jurist”, në Aeroportin e Kukësit.

Drejtori Ekzekutiv i Aviacionit Civil, në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, si dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit të AAC, duhet të rregullojnë pasojat e pavlefshmërisë absolute të aktit të mësipërm, duke e rikthyer nëpunësin ***** në një pozicion të barasvlershëm me pozicionin “Inspektor në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror”, ku ai ka qenë i emëruar në

momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, pasi kjo emërtesë nuk ekziston aktualisht në strukturën e institucionit, si dhe gjithë të drejtat e tjera që sigurohen nga ligji për nëpunësin civil.

3. Për punonjësit ***** dhe *****, të cilët nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse DAP, duhet të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil, për arsye se, këta punonjës nuk plotësojnë kushtet ligjore, për të punuar në një pozicion të caktuar të shërbimit civil. Pas kësaj, njësia e burimeve njerëzore, pranë AAC, duhet të përmbyllë procesin, duke vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e mësipërm, në zbatim të pikës 6, të vendimit 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ata nuk zotërojnë diplomë të arsimit të lartë.

Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

4. Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të përfundojë procedurën e kërkuar në këtë dispozitë të ligjit dhe në përfundim të shprehet për statusin e punësimit, për punonjësen *****.
5. Drejtuesi i institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të mëposhtme të emërimit, duke ndërprerë marrëdhënien e punës dhe atë financiare me institucionin, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit, të nxjerra nga titullari i institucionit:
 1. *****, “Specialist këshilltar”, në Sektorin e Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 129, datë 12.03.2014.
 2. *****, “Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit”, emëruar me urdhrin nr.300, datë 30.04.2014.
 3. *****, “Inspektor i Mbikëqyrjes Koncesioneve”, emëruar me urdhrin nr. 190, datë 12.03.2014.
 4. *****, “Inspektor i Mbikëqyrjes Koncesioneve”, emëruar me urdhrin nr. 192, datë 12.03.2014.
 5. *****, “Drejtore i Drejtorisë së Mbikëqyrjes”, emëruar me urdhrin nr. 142, datë 12.03.2014.

6. *****, “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Sigurisë*”, emëruar me urdhrin nr. 183, datë 12.03.2014.
7. *****, “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Sigurisë*”, emëruar me urdhrin nr. 189, datë 12.03.2014.
8. *****, “*Inspektor i Certifikimit të Personelit*”, emëruar me urdhrin nr. 149, datë 17.03.2014.
9. *****, “*Inspektor i Standardizimit Teknik*”, emëruar me urdhrin nr. 292, datë 25.04.2014.
10. *****, “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Licencimit OA*” emëruar me urdhrin nr.293, datë 25.04.2014.
11. *****, “*Inspektor i Standardizimit Teknik*” emëruar me urdhrin nr. 294, datë 25.04.2014.
12. *****, emëruar “*Përgjegjës në Sektorin e Informacionit*”, me aktin nr. 459, datë 04.10.2016, të Drejtorit Ekzekutiv.
13. *****, emëruar “*Specialist në Sektorin e Informacionit*”, me aktin nr. 231, datë 20.4.2017, të Drejtorit Ekzekutiv.
14. *****, emëruar “*Inspektor i Licencimit të Personelit*”, me aktin nr. 464, datë 10.10.2016, të Drejtorit Ekzekutiv.
15. *****, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes Teknike*”, me aktin nr. 389, datë 24.07.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
16. *****, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes Operacionale*”, me aktin nr. 596, datë 30.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
17. *****, emëruar “*Inspektore e Vlefshmërisë Ajrore*”, me aktin nr. 544, datë 09.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
18. *****, emëruar “*Inspektor i Parrezikshmërisë dhe Certifikimit*”, me aktin nr. 191, datë 24.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
19. *****, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes së Masterplaneve*”, me aktin nr. 233, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
20. *****, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes së Masterplaneve*”, me aktin nr. 236, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
21. *****, emëruar “*Inspektor i Certifikimit të Personelit të Sigurisë*”, me aktin nr. 170, datë 15.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
22. *****, emëruar “*Inspektor i Certifikimit të Personelit të Sigurisë*”, me aktin nr. 229, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
23. *****, emëruar “*Inspektor i Standardizimit Teknik*”, me aktin nr. 232, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
24. *****, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 197, datë 31.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
25. *****, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 235, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
26. *****, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 227, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv

27. *****, emëruar “Përgjegjës i Licencimit, Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror”, me aktin nr. 505, datë 10.11.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
 28. *****, emëruar “Specialist i Burimeve Njerëzore”, me aktin nr. 171, datë 15.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
 29. *****, emëruar “Specialist i Burimeve Njerëzore”, me aktin nr. 239, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
 30. *****, emëruar “Përgjegjës i Prokurimeve dhe Shërbimeve”, me aktin nr. 591, datë 30.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
 31. *****, emëruar “Specialist i Prokurimeve dhe Shërbimeve”, me aktin nr. 230, datë 20.4.2017, të Drejtorit Ekzekutiv.
- ✓ Njësia përgjegjëse, fillimisht duhet të planifikojë nevojat e rekrutimit dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të vijojë procesin e plotësimit të tyre sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.
 - ✓ Planii veprimit duhet t’i paraqitet për miratim Komisionerit, brenda afatit të paralajmërimit dhe më tej, do të ndiqet zbatimi i tij nga Sekretariati Teknik i Komisionerit, sipas afateve të vendosura në këtë vendim.
6. Drejtori Ekzekutiv i AAC, në zbatim të nenit 111, të Kodit të Procedurës Administrative, për shkak se nuk janë zbatuar procedurat ligjore, duhet tëkonstatojëaktet e emërimit, si akte të nxjerranë kundërshtim me nenin 26, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhetë vendosë ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe financiare me funksionin përkatës.
- *****, emëruar Drejtor i Mbikëqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve, me urdhrin nr. 450, datë 29.9.2016, të Drejtorit Ekzekutiv.
 - *****, emëruar Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, me urdhrin nr. 128, datë 12.3.2014, të Drejtorit Ekzekutiv.
 - *****, emëruar Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit, me urdhrin nr. 504, datë 10.11.2016 të Drejtorit Ekzekutiv.
- ✓ Njësia përgjegjëse, duhet të trajtojë nëpunësit e mësipërm, sipas kategorisë së pozicionit të punës, që kanë përfituar në mbështetje të legjislacionit në fuqi.
 - ✓ Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

7. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e punonjësve të deklaruar në periudhë prove (*për shkak të ligjit*), duhet të marrë masa për të finalizuar këtë proces, duke ndjekur hapat e mëposhtme:
- ✓ Pas përfundimit të trajnimit dhe mbi bazën e vlerësimeve të rezultateve në punë, eprori direkt, pasi të marrë mendimin nga nëpunësi më i vjetër, duhet të finalizojë periudhën e provës për këta punonjës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të pikës 7, Kreu VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
 - ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësve dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
 - ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të pikës 13, Kreu VI, të aktit normativ të mësipërm, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit individual të deklarimit të statusit të punësimit për secilin nëpunës
8. Punonjësit e ngarkuar me hartimin e përshkrimeve të punës në institucion, sipas hierarkisë së përcaktuar ligjore, mbështetur në kërkesat e ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, duhet të fillojnë menjëherë procesin e hartimit të këtij formulari dhe miratimin e tij, sipas këtij rendi pune:
- ✓ Të përfundojë hartimii përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi, si dhe udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017 “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, të Departamentit të Administratës Publike.
 - ✓ Drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në cilësinë e analistit të punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës, të mbledhë informacionin e nevojshëm për çdo pozicion pune, ku të përcaktohen qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion të shërbimit civil.
 - ✓ Format i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, pjesë përbërëse e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i

ndryshuar,udhëzimit nr.1 datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, të Departamentit të Administratës Publike dhe të ketë të përfshirë të gjithë elementet, siç janë të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.

- ✓ Të kërkohej zyrtarisht mendimi Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil.
- ✓ Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës, në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave.
- ✓ Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

Në zbatim të detyrave ligjore, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike të drejtojë punën, për të siguruar efikasitetin e strukturës së institucionit për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me ligjin për shërbimin civil dhe detyrat ligjore të institucionit, si dhe për të finalizuar sa më parë procesin e përshkrimeve të punës në këtë institucion.

9. Nga ana e institucionit të mbikëqyrur, të kryhet një analizë e plotë e veprimtarisë së aktorëve të përcaktuar nga ligji, për administrimin e aspekteve të ndryshme të shërbimit civil. Njësia që menaxhon burimet njerëzore të institucionit në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë institucion, duhet të përcaktojë përgjegjësitë konkrete për situatën kaotike, të krijuar në menaxhimin e burimeve njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil. Institucioni dhe DAP, duhet të informojnë Komisionerin për konkluzionet e arritura, si dhe masat e marra për përmbushjen e detyrave të lëna në këtë pikë të vendimit.
10. Për kryerjen e këtyre veprime administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

- 11.** Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të njoftojë me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
- 12.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 13.** Për këtë vendim të njoftohet Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, si dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha